



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:042671

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05645759

KPPP.nr. 1462/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “FITORJA” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810669474 dhe seli në Ferizaj, rr. “e Reçakut”, kundër debitorit Komuna e Ferizaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1/2022 të lejuar me datë 05.01.2022, nga Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Ferizaj ashtu që ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr. 1/2022, i lejuar me datë 05.01.2022 nga Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm Faturës nr. 0004-12/20, e datës 29.09.2020; Faturës nr. 0004-14/20, e datës 20.10.2020 dhe Faturës nr. 0004-19/20, e datës 30.12.2020, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1/2022, të datës 05.01.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që pas pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 1,235.40 EUR me kamatë ligjore prej 8%, deri në pagesën e plotë, si shpenzimet e procedurës përmbartimore, si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në vlerë prej EUR 104.00.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se detyrimi ndaj kreditorit është përmbushur dhe vërtetohet në bazë të urdhër obligimit për pagesë të datës 15.04.2021 me nr. të referencës 656210768, në vlerë prej 971.10 € për faturën nr. 0004-12/20 dhe faturën nr. 0004-14/20, si dhe urdhër obligimit për

pagesë të datës 15.04.2021 me nr. të referencës 656210874, në vlerë prej 264.30 € për faturën nr. 0004-19/20. I ka propozuar gjykatës që të hedhet poshtë si i pa lejueshëm urdhri përmbarimor P.nr. 1/2022.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim janë të pa bazuara për faktin se pagesat e pretenduara nuk janë transferuar në xhirollogari të kreditorit, ashtu që fakti që i njëjti ka lëshuar urdhër obligimet për pagesë nuk dëshmon që ka kryer realizuar pagesat. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata, duke iu referuar shkresave të lëndës, gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarim dhe i lejuar me urdhrin përmbarimor mbi bazën e Faturës nr. 0004-12/20, e datës 29.09.2020; Faturës nr. 0004-14/20, e datës 20.10.2020 dhe Faturës nr. 0004-19/20, e datës 30.12.2020, është përmbushur në tërësi nga ana e debitorit. Deri në një konstatim të tillë, gjykata erdhi duke u bazuar në urdhër obligimin për pagesë të datës 15.04.2021 me nr. të referencës 656210768, në vlerë prej 971.10 €, si dhe urdhër obligimit për pagesë të datës 15.04.2021 me nr. të referencës 656210874, në vlerë prej 264.30 €, të cilat gjenden në shkresa të lëndës dhe përmes së cilave rezulton se debitori ka kryer pagesën në llogari të kreditorit në shumë prej EUR 1,235.40.

Nisur nga një gjendje e tillë, gjykata duke u bazuar në nenin 71, paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, ka aprovuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor, nuk prodhon efekt juridik për shkak të përmbushjes nga ana e debitorit.

Ndërsa, vendimi mbi përfundimin e procedurës përmbarimore gjykata e mbështeti në nenin 66, paragrafi 4 të LPP-së, sipas së cilit përcaktohet se: *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit*

nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”, dhe nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: “Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”.

Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratimet e kreditorit se pagesat e debitorit nuk kanë dalur asnjëherë në llogarinë e kreditorit, mirëpo gjeti se përkundër faktit se në urdhërpagesat e datës 15.04.2021, debitori nuk ka specifikuar numrin e faturave, shuma e paguar në llogari të kreditorit përputhet në tërësi me shumën e cila është përcaktuar në dokumentin e besueshëm, çka nënkupton se pagesa e kryer e debitorit përmes urdhër pagesave është bërë pikërisht në emër të faturave mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor, ndërsa kreditori, nuk ka ofruar prova për të vërtetuar se në xhirollogarinë bankare të të njëjtit, nuk janë bartur këto mjete.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1462/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.